



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Mbështetur në nenin 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L-040, nenin 48 parag.1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, nenit 16 të Rregullores për përbërjen, kompetencat dhe rregullat e punës të Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit,

THËRRAS

Mbledhjen e XV-të (pesëmbëdhjetë - mandati VII) të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **26 shtator 2023**, duke filluar nga **ora 10:00**, në ndërtesën e Komunës, salla e mbledhjeve të Kuvendit, me këtë,

REND TË DITËS

1. Procesverbal nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 28 korrik 2023.
2. Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026
3. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri
4. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024
5. Propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF
Raporti nga diskutimi publik
6. Propozim Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 & Raporti nga diskutimi publik
7. Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024
8. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal- POEL & draft Plani Operativ Emergjent Lokal- POEL
9. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 & draft Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026

Nr.Prot. 01-016/01-0069479/23
Podujevë, datë; 18.09. 2023

